



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 22

Tiranë – E enjte, 11 shkurt 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 13/2021, datë 8.2.2021	Për mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014, ‘Për shërbimin privat të sigurisë fizike’, të ndryshuar”..... 2659
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1176, datë 24.12.2020	Për një shtesë në vendimin nr. 673, datë 2.9.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, të ndryshuar..... 2659
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1178, datë 24.12.2020	Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje..... 2659
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1180, datë 24.12.2020	Për përcaktimin e procedurave të veçanta të legalizimit në favor të poseduesve të objekteve me shkelje të lejes së ndërtimit, si dhe rregullat për përfundimin e procedurës nga subjektet dhe/ose shoqëritë ndërtuese apo investitore..... 2663
Udhëzim i ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë nr. 3, datë 8.2.2021	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore 2021..... 2668
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 65, datë 4.2.2021	Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të procedurës dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit..... 2670
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 66, datë 4.2.2021	Për miratimin e formatit të regjistrimit për regjistrimin e dekretit për fitimin, rifitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare..... 2675
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 53, datë 4.2.2021	Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së deklaratës së ekspertit për marrjen dijeni për përgjegjësinë penale në rast ekspertimi të rremë..... 2676

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 65, datë 1.2.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 682, datë 21.12 2020, “Për ndalimin e lëvizjes përmes rrugëve ajrore me Britaninë e Madhe”, të ndryshuar.....	2678
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 101, datë 15.12.2020	Autorizim i ndihmës shtetërore “Për fuqizimin e të rinjve dhe të të rejave”.....	2678



VENDIM
Nr. 13/2021

PËR MOSMIRATIMIN E
PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA
DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.
75/2014, ‘PËR SHËRBIMIN PRIVAT TË
SIGURISË FIZIKE’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 6, e 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014, ‘Për shërbimin privat të sigurisë fizike’, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 8.2.2021.

VENDIM
Nr. 1176, datë 24.12.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
673, DATË 2.9.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PAJISJEN ME
NUMËR TELEFONI CELULAR TË
FUNKSIONARËVE PUBLIKË”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 6, të vendimit nr. 673, datë 2.9.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas funksionit “zëvendësministër” shtohen funksionet “këshilltar/analist/ndihmës”, në kabinetin e

Kryeministrit, dhe “drejtor departamenti” në Kryeministri.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1178, datë 24.12.2020

PËR PËRCAKTIMIN E
DOKUMENTACIONIT DHE TË
RREGULLAVE TË HOLLËSISHME TË
EVIDENTIMIT TË NDËRTIMEVE PA
LEJE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, pika 6, dhe 69, pika 9, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme për evidentimin e ndërtimeve pa leje, proces i cili përbëhet nga dy etapa:

a) evidentimi në terren i gjendjes ndërtimore;

b) evidentimi i faktit nëse ndërtimi përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me nenet 17, pika 1, dhe 69, pika 9, të tij.

2. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Skicë fushore”, dokumenti manual që hartohet nga punonjësit e evidentimit në terren dhe që përmban skicimin e ndërtimit pa leje të parcelës dhe përmasat e tij.

b) “Akt i evidentimit në terren”, dokumenti tekniko-juridik, që hartohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në vijim ASHK, ku pasqyrohet gjendja faktike e ndërtimit pa leje dhe e parcelës ndërtimore, sipas përditësimit në terren.



3. Evidentimi në terren i ndërtimeve pa leje kryhet nga drejtoritë vendore të ASHK-së, sipas njësisë strukturore “bllok kadastral”. Përrjashtimisht, evidentimi nuk kryhet sipas njësisë strukturore “bllok kadastral”, në rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 21, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, kur subjekti posedues kërkon legalizimin me procedurë të përrshpejtuar.

4. Kur subjekti posedues kërkon legalizimin në mënyrë të përrshpejtuar, të gjitha procedurat administrative të parashikuara në këtë vendim, së bashku me vendimmarjen për legalizimin ose jo të ndërtimit, kryhen brenda afatit 30-ditor të përrcaktuar në pikën 2, të nenit 21, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

II. EVIDENTIMI NË TERREN I GJENDJES NDËRTIMORE

5. Procesi i evidentimit në terren i gjendjes ndërtimore përrfshin:

a) përrditësimin e gjendjes ndërtimore dhe hartimin e “skicës fushore” për ndërtimin së bashku me parcelën ndërtimore;

b) plotësimin e të gjitha elementeve të aktit të evidentimit, përrfshirë edhe funksionin, për çdo ndërtim pa leje, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përrbërëse e tij;

c) hartimin e genplanit dhe planimetrisë, sipas gjendjes së përrditësuar për çdo ndërtim pa leje;

ç) krijimin e hartës së bllokut kadastral me gjendjen ndërtimore të përrditësuar, në format elektronik dhe në *hard copy*;

d) plotësimin e bazës të të dhënave të ndërtimeve pa leje me informacionin e përrftuar nga përrditësimi në terren i gjendjes ndërtimore.

Vetëm pasi të ketë kryer procedurat administrative të mësipërme, së bashku me verifikimet sipas kreut III, të këtij vendimi, drejtoria vendore e ASHK-së vijon me procesin e legalizimit të ndërtimit.

6. Për ndërtimet pa leje që futen në kategorinë e objekteve me shkelje të lejes së ndërtimit, drejtoria vendore e ASHK-së administron kopjen e njësuar me origjinalin, të dokumentacionit të lejes së ndërtimit nga autoriteti i zhvillimit të territorit. Ky dokumentacion shërben vetëm për të identifikuar sipërfaqet në tejkalim të lejes së ndërtimit, si dhe, nëse është rasti, ndryshimet e ndarjes dhe të

funksionit të hapësirave. Në çdo rast, procedura administrative vijon sipas gjendjes ndërtimore të evidentuar në terren.

7. Evidentimi në terren i ndërtimit pa leje kryhet vetëm një herë, me përrjashtim të rastit kur, si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore të ankimit, është vendosur kryerja e një evidentimi tjetër, në funksion të shqyrtimit të ankimit.

8. ASHK-ja nuk është përrgjegjëse për ndryshimet e gjendjes ndërtimore apo të funksionit të ndërtimit pa leje, të realizuara pas evidentimit në terren, sipas datës së aktit të evidentimit.

9. Kur nga evidentimi në terren është i pamundur të përrcaktohet funksioni i ndërtimit pa leje, atëherë poseduesi i ndërtimit duhet të deklarojë destinacionin e përrdorimit të tij, nëpërrmjet një akti noterial. Në rast se poseduesi nuk e dorëzon këtë deklaratë noteriale brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi shkresor i marrë nga drejtoria vendore e ASHK-së, atëherë procedurat administrative vijnë duke prezumuar se funksioni i ndërtimit është social-ekonomik.

Kjo pikë nuk zbatohet për objektet me funksion të papërrcaktuar, që gjenden në kushtet e pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Për këto objekte vepohet sipas përrcaktimeve të vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përrcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”.

10. Nëse poseduesi i ndërtimit pa leje, me veprime konkrete, nuk lejon punonjësit e ASHK-së të kryejnë përrditësimin e gjendjes ndërtimore në terren, drejtori vendor i ASHK-së vendos, me urdhër, pezullimin e procedurës administrative, sipas pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Përrfundimi i pezullimit, sipas kësaj pike, ndodh me paraqitjen e kërkesës për rifillimin e procedurave nga poseduesi i ndërtimit pa leje. Nëse poseduesi nuk paraqet kërkesë, brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e njoftimit të urdhrat të pezullimit, ASHK-ja i kërkon atij, në rrugë shkresore, nëpërrmjet postës së porositur, të shprehet për gatishmërinë e tij për të kryer evidentimin në terren dhe për datën përrkatëse.



Nëse poseduesi nuk i përgjigjet drejtorisë vendore të ASHK-së me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës, atëherë kjo e fundit deklaron, me urdhër, përfundimin e procedurës administrative pa vendim përfundimtar, në përputhje me nenet 90, pika 3, dhe 94, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative. E njëjta rregull zbatohet edhe nëse, pas përgjigjes së tij, poseduesi nuk paraqitet në datën e dakordësuar ose sërish pengon evidentimin në terren.

11. Përfundimisht nga sa është përcaktuar në pikën 10 të këtij vendimi, procedura administrative nuk pezullohet dhe, nëse është pezulluar, rifillon, në rastin kur ndërtimi pa leje që evidentohet preket nga një projekt ose vepër e infrastrukturës, që përbën interes publik, në kuptim të legjislacionit për shpronësimet për interes publik ose nëse cenon sigurinë e jetës, të shëndetit të vetë poseduesit apo të të tretëve, apo pasurinë e tyre.

III. EVIDENTIMI I PËRFSHIRJES SË NDËRTIMIT PA LEJE, NË FUSHËN E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 20/2020, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCESEVE KALIMTARE TË PRONËSISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

12. Për ndërtimin pa leje që nuk është aplikuar më parë për legalizim aplikohet, nëpërmjet platformës unike qeveritare *e-Albania*, kundrejt tarifës së aplikimit prej 3 000 (tre mijë) lekësh. Formulari i kërkesës për legalizim është sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

13. Gjatë procesit të evidentimit në terren të bllokut kadastral/ndërtimit, drejtoria vendore e ASHK-së evidenton edhe nëse ai përfshihet ose jo në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, në Republikën e Shqipërisë”, sipas neneve 17, pika 1, dhe 69, pika 9.

14. Ndërtimet pa leje, që janë të pranishëm në ortofoton e realizuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, nga autoriteti shtetëror përgjegjës për informacionin gjeohapësinor, janë të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit të sipërpërmendur, në përputhje me pikën 1, të nenit 17, pavarësisht llojit, funksionit apo vendndodhjes së tyre. Verifikimi për praninë e tyre në ortofoto kryhet nëpërmjet Gjeoportalit të

krijuar e të administruar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, duke iu referuar produkteve të ortoimazherisë, me emërtesat “ortofoto 2015”, në vijim, “ortofoto”.

Nëse nga evidentimi në terren rezulton se ndërtimi ka ndryshime të sipërfaqes, shtesa apo ndryshime të konfigurimit, në raport me gjendjen e pasqyruar në “ortofoto”, atëherë i gjithë ndërtimi konsiderohet i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, bashkë me shtesat, sipas gjendjes faktike të evidentuar në terren.

15. Ndërtimet që nuk gjenden në “ortofoto” përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, nëse, në përputhje me pikën 9, të nenit 69, plotësojnë njëkohësisht këto kushte:

a) janë ngritur në strukturë përpara datës 7.5.2020, ku “struktura” është tërësia e elementeve horizontale dhe vertikale mbajtëse, përfshirë edhe sistemin e lidhjes me tokën dhe mbulesën;

b) për to nuk është vendosur më parë prishja apo konfiskimi, sipas ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, ose këto dënime janë parashkruar, shfuqizuar, anuluar, konstatuar të pavlefshme, në rrugë administrative ose gjyqësore. Këtij kushti, si rregull, i nënshtrohen vetëm “objektet me shkelje të lejes së ndërtimit” dhe “shtesat në ndërtime të regjistruara”. Ndërtimet pa leje të llojit “objekt” përfshihen në fushën e zbatimit, pavarësisht sanksioneve të mësipërme, nëse ato nuk janë ekzekutuar deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe nuk janë vendosur ose lënë në fuqi me vendim gjyqësor të formës së prerë. Dokumentacioni provues, sipas kësaj shkronje, administrohet, sipas rastit, nga autoritetet përgjegjëse të inspektimit ose/dhe autoritetet e zhvillimit dhe kontrollit të territorit.

c) Kanë funksion banimi ose bujqësor-blegtoral, për ndërtimet që janë ngritur në territorin e fshatrave. Në territorin e qyteteve përfshihen vetëm ndërtimet pa leje të llojeve “shtesa në ndërtime të regjistruara” dhe “objekte me shkelje të lejes së ndërtimit”, pavarësisht funksionit të tyre.



16. Për të konstatuar nëse ndërtimi pa leje është ndërtuar në strukturë përpara datës 7.5.2020, drejtoritë vendore të ASHK-së mbështeten, në:

a) ortofotot e publikuara në Gjeoportali për pjesët e territorit të Republikës së Shqipërisë që ato pasqyrojnë;

b) imazhet satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga subjektet disponuese;

c) planrilevimet, si dokumentacion hartografik i hartuar në kuadër të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, të administruara nga ASHK-ja;

ç) vendime gjyqësore për vërtetim të faktit se ndërtimi është ngritur para datës 7.5.2020 ose çdo vendim tjetër gjyqësor që e provon këtë fakt;

d) aktekspertiza nga një grup prej të paktën 3 (tre) ekspertësh, inxhinierë të licencuar, që të përcaktojë periudhën e ngritjes dhe vjetërsinë e ndërtimit;

dh) dokumente të tjera zyrtare, juridikisht të vlefshme, që provojnë ekzistencën e ndërtimit pa leje në momentin kohor të dhënë, në një datë dhe vend të caktuar.

Dokumentacioni, që provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi pa leje, administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit të ndërtimit pa leje. Barrën e provës për rastet e parashikuara në shkronjat “c” deri në “d”, të kësaj pike, e ka poseduesi i ndërtimit pa leje.

17. Për të konstatuar nëse ndërtimi pa leje që gjendet në kushtet e shkronjës “c”, të pikës 15, të këtij vendimi, është në territorin administrativ të fshatit, ASHK-ja administron kopje të dokumentacionit hartografik të kufijve të fshatrave, nga këshilli i bashkisë përkatëse, në përputhje me pikën 2, të nenit 93, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar. Në mungesë të tij, administrohet konfirmimi shkresor nga organet e njësisë administrative përkatëse për vendndodhjen e ndërtimit, në raport me ndarjen administrative të fshatrave dhe qyteteve.

18. Pas procedurës së parashikuar në pikën 17, të këtij vendimi, drejtoria vendore e ASHK-së evidenton përfshirjen ose jo të ndërtimit pa leje në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me urdhër të arsyetuar të drejtorit vendor. Për ndërtimet pa leje që nuk përfshihen në fushën e zbatimit, procedura administrative përfundon me urdhrin për

evidentimin e mospërfshirjes, i cili bëhet i ekzekutueshëm, duke njoftuar autoritetet e kontrollit të zhvillimit të territorit/inspektimit të ndërtimit, vetëm pas shterimit të ankimit administrativ, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

19. Poseduesi i ndërtimit pa leje, që nuk përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, nuk trajtohet nga shteti me skemën e parashikuar në nenin 33, të ligjit të sipërpërmendur.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

20. Për kryerjen e procedurave të përcaktuara në kreun II, të këtij vendimi, ASHK-ja mund të kontrakttojë subjekte private, të licencuara në fushat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

21. Subjektet, që kanë bërë kërkesë për legalizim nga data 7.5.2020 deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe për të cilat nuk është miratuar vendimi për legalizim, duhet të shlyejnë tarifën e aplikimit të parashikuar në pikën 12 të tij.

22. Modeli dhe mënyra e plotësimit të dokumentacionit teknik përcaktohen me udhëzim të drejtorit të përgjithshëm të ASHK-së.

23. Vendimi nr. 589, datë 10.9.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale”, i ndryshuar, shfuqizohet.

24. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**VENDIM****Nr. 1180, datë 24.12.2020****PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
TË VEÇANTA TË LEGALIZIMIT NË
FAVOR TË POSEDUESVE TË
OBJEKTEVE ME SHKELJE TË LEJES SË
NDËRTIMIT, SI DHE RREGULLAT PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS NGA
SUBJEKTET DHE/OSE SHOQËRITË
NDËRTUESE APO INVESTITORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 31, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të legalizimit të objekteve me shkelje të lejes së ndërtimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 31, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

2. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Objekt me shkelje të lejes së ndërtimit”, i njëjti kuptim i përcaktuar në pikën 13, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

b) “Ligji”, ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

c) “Ortofoto”, produkti i ortoimazherisë së realizuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, që gjendet në Gjeoportalin Kombëtar të krijuar dhe administruar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, me emërtesat “ortofoto 2015”.

3. Trajtohen në bazë të dispozitave të këtij vendimi objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit, sipas përcaktimeve të neneve 17 dhe 69, pika 9, të tij.

Si rregull, objekti me shkelje të lejes së ndërtimit, që trajtohet sipas këtij vendimi, nuk është i regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, edhe nëse është pasqyruar në regjistrat e posaçëm të lejes së ndërtimit dhe/ose të karabinasë. Përfundimisht, nëse objekti me shkelje të lejes së ndërtimit është i regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, ai mund të trajtohet sipas dispozitave të këtij vendimi, vetëm nëse regjistrimi është kryer pa miratimin e certifikatës/lejes së përdorimit/shfrytëzimit apo të aktit administrativ analog, nga autoriteti i zhvillimit të territorit, sipas legjislacionit të kohës ose nëse ky akt është shfuqizuar, anuluar apo konstatuar i pavlefshëm, në rrugë administrative ose gjyqësore.

4. Kur në objektin me shkelje të lejes së ndërtimit kanë kryer dhe deklaruar shtesa edhe poseduesit e njësive individuale, procedurat e legalizimit dhe të regjistrimit kryhen në dy faza:

a) legalizimi i sipërfaqes së objektit sipas lejes, duke përfshirë edhe shtesat anësore dhe/ose në lartësi të kryera nga subjekti investitor, nëse ka të tilla, dhe regjistrimi i saj në regjistrin e pasurive të paluajtshme;

b) pas zbatimit të procedurave të shkronjës “a”, të kësaj pike, ASHK-ja shqyrton legalizimin e shtesave anësore dhe/ose në lartësi, të kryera dhe të deklaruara nga vetë subjektet poseduese.

5. Në objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, vetëm sipërfaqet në tejkallim të lejes së ndërtimit (shtesat) u nënshtrohen kriterëve të moslegalizimit, sipas nenit 18, të ligjit, kur ato janë të ndashme nga ndërtimi me leje. Në rastet kur shtesat janë të ndashme, nëse ato gjenden në kushtet e përjashtimit nga legalizimi, legalizohet dhe regjistrohet vetëm sipërfaqja ndërtimore me leje ndërtimi.

Në rastet kur sipërfaqet shtesë nuk janë të ndashme, objektet me shkelje të lejes së ndërtimit legalizohen në tërësi, në përputhje me përcaktimet e pikës 3, të nenit 18, të ligjit.

6. Problematikat e pozicionimit të objektit me shkelje të lejes së ndërtimit dhe/ose të sheshit të ndërtimit zgjidhen, duke u mbështetur në gjendjen faktike ndërtimore, të evidentuar në terren. Drejtoritë vendore të ASHK-së vijojnë legalizimin sipas këtij evidentimi, pavarësisht nga ndryshimi midis gjendjes faktike dhe dokumentacionit të lejes së lëshuar nga autoriteti vendor.



II. LEGALIZIMI NË FAVOR TË POSEDUESVE

7. Procedurat e legalizimit të objektit me shkelje të lejes së ndërtimit vijojnë në favor të përfituesve të njësive individuale, si porositës apo pronarë truall, sipas kontratave ose aktmarrëveshjeve përkatëse, nëse:

a) subjekti investitor është në kushtet e prishjes së shoqërisë tregtare, të falimentit, ose pezullimit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare; ose

b) subjekti investitor nuk plotëson detyrimet e tij ligjore në procedurën e legalizimit, duke e braktisur atë.

8. Në kuptim të shkronjës “b”, të pikës 7, të këtij vendimi, subjekti investitor konsiderohet se nuk plotëson detyrimet e tij ligjore në procedurën e legalizimit, nëse verifikohet një nga këto rrethana:

a) Subjekti investitor nuk ka aplikuar për legalizim, brenda njërit prej afateve të mëposhtme, në varësi të rastit:

i. brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, që nuk bënë pjesë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i shfuqizuar, dhe përfshihen për herë të parë në procesin e legalizimit, pas hyrjes në fuqi të ligjit; ose

ii. deri në datën 17.1.2017, si koha e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 19, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit që përfshiheshin në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të sipërpërmendur, të shfuqizuar, si ndërtime të ngritura përpara datës 27.6.2014. Në këto raste, investitorët, që nuk kanë aplikuar deri në datën 17.1.2017, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të vendimit të sipërpërmendur, nuk kanë më të drejtë të aplikojnë për legalizim dhe procedurat vijojnë drejtpërdrejt në favor të përfituesve të njësive individuale.

b) Subjekti investitor nuk përmbush brenda 30 (tridhjetë) ditëve kërkesën e Drejtorisë Vendore të ASHK-së për të plotësuar të gjitha detyrimet dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

i. të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin të aktmarrëveshjes apo kontratës së lidhur me pronarët e truallit të sheshit të ndërtimit, për

përcaktimin e pjesëve ose njësive të tyre në ndërtimin kryesor;

ii. të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin të aktmarrëveshjes apo kontratës, së lidhur me pronarët e truallit, për përcaktimin e pjesëve ose njësive të tyre, në shtesën/shtesat tej lejes së ndërtimit, nëse ka të tillë;

iii. të dorëzojë aktekspertizën nga një ekspert, ose ent i licencuar, për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit me shkelje të lejes së ndërtimit;

iv. të shlyejë vlerën e tarifës së shërbimit, sipas nenit 67, të ligjit, e cila llogaritet për çdo kat të objektit me shkelje të lejes së ndërtimit;

v. të shlyejë penaltetin për mosrespektimin e lejes së ndërtimit, sipas nenit 67, të ligjit;

vi. në rastin kur objekti nuk është i pranishëm në “ortofoto”, në bazë të pikës 9, të nenit 69, të ligjit, të dorëzojë vërtetimin nga autoritetet përgjegjëse të inspektimit dhe/ose autoritetet e zhvillimit dhe kontrollit të territorit se nuk është vendosur më parë prishja apo konfiskimi ose se këto dënime janë parashkruar, sipas ligjit për kundërvajtjet administrative, apo shfuqizuar, anuluar ose konstatuar të pavlefshme në rrugë administrative ose gjyqësore.

9. Nëse gjatë procedurave të legalizimit të nisura në favor të subjektit investitor sipas vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit për ndërtimet pa leje”, verifikohet një prej rrethanave të parashikuara në pikat 7 ose 8, të këtij vendimi, atëherë drejtoritë vendore të ASHK-së vijojnë procedurën në favor të përfituesve të njësive individuale.

10. Drejtoritë vendore të ASHK-së, pas kryerjes së procedurave të evidentimit në terren, hartojnë listat e ndërtimeve të ngritura nga subjektet që gjenden në kushtet e pikave 7 ose 8, të këtij vendimi, si dhe listën e poseduesve të njësive individuale, dhe i afishojnë ato në faqen zyrtare të ASHK-së, në ambientet e drejtorive vendore dhe të objekteve që do t'i nënshtrohen procesit të legalizimit, si dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.

11. Poseduesit e njësive individuale duhet të dorëzojnë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e afishimit publik, dokumentacionin që provon



marrëdhënien juridiko-civile me subjektin ndërtues/investitor.

12. Drejtoria vendore miraton fillimisht aktin e legalizimit për objektin me shkelje të lejes së ndërtimit, në tërësi sipas shkronjës “a”, të pikës 4, të këtij vendimi. Në këtë rast, akti i legalizimit të të gjithë objektit miratohet duke përcaktuar si përfitues të tij “poseduesit e ndërtimit të legalizuar” dhe regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Objektet e legalizuara në shkelje të lejes u njoftohen bashkive për përditësim prej tyre të të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

13. Pas procedurës së përcaktuar në pikën 12, të këtij vendimi, drejtoria vendore e ASHK-së miraton aktet e legalizimit për njësitë individuale në favor të poseduesve, sipas kontratave ose aktmarrëveshjeve përkatëse.

14. Nëse objekti me shkelje të lejes së ndërtimit është ngritur në truall privat të të tretëve, pronarët e truallit përfitojnë pjesët përkatëse në objektin kryesor dhe në shtesat e realizuara nga subjekti ndërtues/investitor, në përputhje me pikën 2, të nenit 20, të ligjit.

15. Në rast se nga dokumentacioni i dorëzuar pranë ASHK-së rezulton se për të njëjtat njësi ndërtimore investitori ka lidhur edhe kontrata të tjera të mëvonshme porositë/ sipërmarrje/ premtim-shitjeje me të tretë, përveç kontratës/ aktmarrëveshjes që ka lidhur për të njëjtat njësi me pronarët e truallit, atëherë akti i legalizimit për këto njësi miratohet në favor të pronarëve të truallit, në përputhje me pikën 1, të nenit 26, të ligjit.

Në rast se ndonjë nga palët e mësipërme apo të tretë ngrenë padi për njohjen e të drejtave të tyre mbi njësitë individuale dhe ia njoftojnë atë drejtorisë vendore të ASHK-së, atëherë kjo e fundit është e detyruar që ta miratojë aktin e legalizimit pa përcaktuar përfituesin, në përputhje me pikën 2, të nenit 26, të ligjit. drejtoria vendore e ASHK-së nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e vendimit të legalizimit, në rast se nuk është njoftuar për zhvillimin e procesit gjyqësor nga pala e interesuar, shoqëruar me vërtetimin përkatës, ose nga gjykata.

Të njëjtat rregulla si më sipër zbatohen edhe për njësitë, për të cilat konkurrojnë porositë/sipërmarrja/premtim-shitja në favor të dy ose më shumë porositësve.

16. Kur njësitë ndërtimore të përcaktuara në aktmarrëveshjen/kontratën mes pronarëve të truallit dhe investitorit apo mes këtij të fundit dhe porositësve nuk përputhen nga pozicioni ose përmasat me gjendjen faktike të ndërtimit, atëherë veprohet, sipas radhës, në këtë mënyrë:

a) Nisur nga parimi i kontratës së parë në kohë, sipas pikës 15, të këtij vendimi, dhe pikës 1, të nenit 26, të ligjit, ASHK-ja përcakton të parat njësitë e pronarit të truallit, në atë/ato kat/e ose seksion të objektit me shkelje të lejes, ku duhet të gjendeshin njësitë individuale të premtuara atij prej investitorit. Për këtë qëllim, ASHK-ja nisat nga orientimi (faqja e ndërtesës) ose forma e përmasat e përafërta të njësisë, sipas faktit, dhe përcakton atë që është më e ngjashme me përshkrimin e njësisë në kontratë/ aktmarrëveshje, duke e legalizuar në favor të pronarit të truallit.

b) E njëjta rregull zbatohet edhe për njësitë e tjera ndërtimore të porositësve të tjerë.

Drejtoria vendore e ASHK-së udhëhiqet nga posedimi faktik i njërive sipas evidentimit në terren, pas respektimit të rregullave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, pa cenuar të drejtat e pronarëve të truallit, sipas parimit të të parit në kohë.

17. Në rast se për shtesat në tejkalim të lejes së ndërtimit të kryera nga subjekti investitor ky i fundit nuk ka lidhur marrëveshje me pronarët e truallit, atëherë, për të zbatuar rregullën e përcaktuar në fjalinë e fundit, të pikës 2, të nenit 20, të ligjit për sipërfaqet shtesë, drejtoria vendore e ASHK-së mbështetet në të njëjtin raport të sipërfaqeve të premtuara për pronarët e truallit me sipërfaqet e tjera në ndërtimin kryesor, sipas projektit të lejes. Ky raport zbatohet për shtesën dhe drejtoria vendore e ASHK-së detyrohet të legalizojë sipërfaqet takuese në shtesë në favor të pronarëve të truallit, duke iu referuar, për aq sa është e mundur, për analogji, pozicionit/orientimit dhe karakteristikave të njërive të pronarëve të truallit në ndërtimin kryesor. Në pamundësi për të zbatuar raportin e sipërfaqeve, atëherë aplikohet raporti i numrit të njërive të pronarëve të truallit me njësitë e tjera në ndërtimin kryesor.

17.1 Kur shtesa është e pandashme, e paidentifikueshme nga ndërtimi kryesor, atëherë, për të garantuar sipërfaqen e pronarit të truallit



në shtesë, zbatohet rregulla e raportit të sipërfaqeve mbi sipërfaqen totale të objektit me shkelje të lejes sipas gjendjes faktike dhe, nëse është e mundur, pronarëve të truallit u miratohet legalizimi për njësi që përfshijnë edhe pjesën takuese për shkak të shtesës, ose për njësi më vete që e realizojnë këtë qëllim. Kjo rregull, kur pronari i truallit nuk ka marrëveshje të veçantë për shtesën, zbatohet vetëm nëse njësia ose pjesa që i takon në sipërfaqen shtesë nuk u është premtuar të tretëve nga investitori, me kontratë/aktmarrëveshje tjetër. Në të kundërt, kur ASHK-ja e ka të pamundur të zbatojë parashikimet e këtij paragrafi, palët duhet t'i rregullojnë mosmarrëveshjet ndërmjet tyre për sipërfaqet e shtuara në rrugë civile ose gjyqësore.

18. Njësitë individuale, për të cilat nuk janë lidhur kontrata porosie/sipërmarrjeje ose aktmarrëveshje, legalizohen në emër të subjektit ndërtues /investitor, me përjashtim të atyre që i takojnë pronarit të truallit, sipas paragrafit të dytë të fjalisë së fundit, të pikës 2, të nenit 20, të ligjit. Përcaktimi i tyre bëhet duke ndjekur të njëjtat rregulla si në pikën 25, të këtij vendimi. Kur investitori është shuar si subjekt, nuk ekziston më dhe njëkohësisht mbi njësinë individuale nuk ka pretendime nga të tretë, ajo legalizohet në favor të shtetit.

19. Hipoteka ose sekuestroja e regjistruar mbi truallin për ekzekutimin e detyrimit nuk pengon procedurën e legalizimit të objektit me shkelje të lejes dhe të njësive individuale në favor të përfituesve, por mbarten vetëm mbi njësitë individuale që i përkasin pronarit të truallit debitor në marrëdhënien e detyrimit. Kur regjistrimi i hipotekës ose i sekuestros është më i hershëm se aktmarrëveshja ndërmjet investitorit dhe pronarëve të truallit, shtrirja e hipotekës/sekuestros vetëm në njësitë e përcaktuara në aktmarrëveshje duhet detyrimit të miratohet nga kreditori hipotekar apo autoriteti që ka nxjerrë aktin e sekuestros. Në të kundërt, procedura administrative pezullohet në përputhje me nenin 66, të Kodit të Procedurave Administrative.

Në bazë të nenit 534, të Kodit Civil, drejtoria vendore e ASHK-së, në momentet e regjistrimit të objektit në tërësi dhe të akteve të legalizimit të njësive individuale është e detyruar të pasqyrojë në regjister edhe hipotekën ose sekuestron mbi

ato njësi që legalizohen në favor të pronarit të truallit debitor.

19.1 Në rastet kur investitori është njëkohësisht pronar i truallit të hipotekuar ose të sekuestruar, atëherë procedura e legalizimit vijon në emër të porositësve vetëm për ato njësi për të cilat kontrata e porosisë/sipërmarrjes/premtim-shitjes është me e hershme sesa regjistrimi i hipotekës apo sekuestros.

Në të kundërt, kur regjistrimi i hipotekës apo i sekuestros mbi truallin është më i hershëm se sa kontrata e lidhur ndërmjet investitorit dhe porositësit, atëherë njësia individuale legalizohet e regjistrohet në favor të investitorit, duke mbartur mbi të edhe barrën përkatëse, në përputhje me pikën 19, të këtij vendimi. Njëkohësisht, në seksionin F të kartelës së pasurisë për njësinë individuale pasqyrohet edhe pretendimi i porositësit sipas kontratës përkatëse. Në qoftë se investitori është shuar dhe nuk ekziston, legalizimi kryhet në favor të kreditorit hipotekar. Mosmarrëveshjet ndërmjet porositësit, kreditorit hipotekar dhe investitorit zgjidhen ndërmjet palëve në rrugë civile ose gjyqësore, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

20. E njëjta procedurë zbatohet edhe kur trualli është sekuestruar si rrjedhojë e regjistrimit të sigurimit të padisë në procesin gjyqësor civil, sipas nenit 206, të Kodit të Procedurës Civile, ose prej vendimit të gjykatës penale, sipas Kodit të Procedurës Penale. Vendimi për sigurimin e padisë ose për sekuestrimin gjatë procesit penal, që ka për objekt truallin, shkakton pezullimin e procedurave administrative të legalizimit të objektit me shkelje të lejes së ndërtimit, vetëm në rast se gjykata ka urdhëruar shprehimisht pezullimin e tyre, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 27, të ligjit. Në të kundërt, objekti me shkelje të lejes legalizohet dhe siguri i padisë ose sekuestroja penale mbartet detyrimit edhe mbi njësitë ndërtimore që u korrespondojnë pronarëve të truallit të sekuestruar, sipas përcaktimeve të pikës 19 dhe të nënpikës 19.1, të këtij vendimi.

21. E njëjta rregull zbatohet edhe kur objekt i sekuestros/hipotekës është vetë karabinaja, sipas informacionit të regjistrimit të posaçëm të karabinasë ose njoftimit të përmbaruesit, pavarësisht nëse investitori është pronar i truallit ose jo, duke iu referuar njësive ndërtimore të



investitorit, me përjashtim të atyre për të cilat ka kontrata sipërmarrjeje/porosie/premtim-shitjeje me të tretë, që janë më të hershme se sa vetë hipoteka ose sekuestroja, në përputhje me pikën 5, të nenit 50, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

22. Vendimi i sigurimit të padisë ose i sekuestros penale, që ka për objekt vetë karabinanë e objektit me shkelje të lejes, shkakton pezullimin e procedurave administrative të legalizimit të objektit me shkelje të lejes së ndërtimit, vetëm në rast se gjykata ka urdhëruar shprehimisht pezullimin e tyre, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 27, të ligjit. Në të kundërt, objekti me shkelje të lejes legalizohet, por në momentin e regjistrimit, sigurimi i padisë ose sekuestroja penale mbartet detyrimisht mbi të gjithë objektin.

23. Procedurat e legalizimit sipas këtij kreu nuk pengohen nga detyrimet kontraktore që mund të ekzistojnë ndërmjet poseduesve dhe subjektit ndërtues/investitor lidhur me njësitë individuale dhe as nuk i shuajnë këto detyrime.

24. Regjistrimi i njësive individuale dhe i pjesës takuese të bashkëpronësisë kryhet sipas aktit të legalizimit. Poseduesit e njësive individuale, krahas pagesës së tarifës së regjistrimit për këto njësi, paguajnë solidarisht edhe tarifën e regjistrimit të objektit në tërësi.

25. Aktekspertiza për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit në tërësi, sipas nenit 20, të ligjit, administrohet në një nga këto mënyra:

a) depozitohet nga poseduesit e njësive individuale;

b) kontraktohet nga ASHK-ja, nëse për këtë japin pëlqimin poseduesit e njësive individuale. Në çdo rast, kostoja e aktekspertizës duhet të shlyhet nga poseduesit.

26. Penalitetet e llogaritura sipas nenit 43, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të shfuqizuar, ato që llogariten në bazë të nenit 67, të ligjit, si dhe detyrimet tatimore, të parashikuara nga nenet 11 e 20, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, mbarten nga subjekti ndërtues/investitor dhe nuk pengojnë legalizimin në favor të poseduesve, sipas këtij kreu.

Penalitetet llogariten nga drejtoria vendore e ASHK-së dhe i njoftohen Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Nëse subjekti është

duke iu nënshtruar procedurave të falimentimit, ato i njoftohen administratorit të falimentimit, gjykatës kompetente që ka vendosur fillimin e procedurave të falimentimit dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Detyrimet tatimore mbarten nga subjekti ndërtues, edhe pse kalimi i së drejtës së pronësisë mbi njësitë individuale kryhet nga drejtoria vendore e ASHK-së nëpërmjet aktit të legalizimit. Sipas kësaj pike, Drejtoria Vendore e ASHK-së përcjell pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e detyrimeve tatimore.

27. Rastet e parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 7, të këtij vendimi, për efekt të detyrimeve të subjektit ndërtues/investitor për pagesën e penalitetit dhe tatimit, trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi nga institucionet tatimore dhe ato të mbikëqyrjes së shoqërive tregtare.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

28. Deri në miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, llogaritja e penalitetit për shkeljen e lejes së ndërtimit kryhet në këtë mënyrë:

a) 2 për qind të çmimit minimal fiskal, për çdo m² sipërfaqe banimi;

b) 5 për qind të çmimit minimal fiskal, për çdo m² sipërfaqe që shfrytëzohet për veprimtari social-ekonomike;

c) 10 për qind të çmimit minimal fiskal, për çdo m² sipërfaqe që është bërë ndryshim destinacioni.

Për identifikimin e çmimit minimal fiskal, drejtoritë vendore të ASHK-së mbështeten në përcaktimet e vendimit nr. 860, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, të ndryshuar.

29. Në rastin kur rezulton se objekti/sheshi i ndërtimit shtrihet jashtë truallit të përcaktuar në lejen e ndërtimit, drejtoritë vendore të ASHK-së procedojnë sipas neneve 22 dhe 24 të ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, nëse nuk arrihet marrëveshje juridiko-civile ndërmjet palëve private.



Këto dispozita zbatohen edhe kur ka ndryshime të gjendjes juridike të pronësisë të sheshit të ndërtimit, në raport me dokumentacionin e lejes përkatëse të ndërtimit.

30. Objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, për të cilat procedura administrative ka nisur përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe nuk është përfunduar ende, u nënshtrohen rregullave të këtij vendimi.

31. Vendimi nr. 19, datë 11.1.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të legalizimit të objekteve me leje ndërtimi, në të cilat janë kryer shtesa anësore dhe/ose në lartësi ose ndryshime të funksionit të hapësirave dhe të objekteve shumëkatëshe pa leje, të destinuara për kalimin e së drejtës së pronësisë apo qiradhënien”, shfuqizohet, me përjashtim të kreut III, i cili mbetet në fuqi deri në miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

32. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Falimentimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

UDHËZIM
Nr. 3, datë 8.2.2021

PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË MATURËS SHTETËRORE 2021

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore 2021, për arsimin e mesëm të lartë, të jenë:

a) Provime të detyruara: gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë dhe gjuhë e huaj;

b) Një provim me zgjedhje.

2. Provime të detyruara

a) Provimet e detyruara të mbështeten vetëm në kurrikulën bërthamë. Programet orientuese të provimeve të detyruara (gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, gjuhë e huaj) për të gjithë maturantët/kandidatët të jenë në përshtatje me programet ekzistuese të arsimit të mesëm të lartë.

b) Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën, e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm të lartë.

c) Lista e gjuhëve të huaja, që jepen si provim i detyruar (D3) është: anglisht, frëngjisht, italisht dhe gjermanisht. Gjuha e huaj si provim i detyruar përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z.

3. Provimi me zgjedhje

a) Lista e lëndëve të provimit me zgjedhje të jetë:

Kimi;
Fizikë;
Biologji;
Histori;
Gjeografi;
Qytetari dhe psikologji;
Filozofi dhe sociologji;
Ekonomi;
Histori arti;
Histori muzike;
Histori baleti.

b) Programet orientuese të lëndëve me zgjedhje të jenë të njëjta për të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z.

c) Programi orientues i lëndëve me zgjedhje përmban programin e lëndës bërthamë dhe atë me zgjedhje.

d) Maturanti/kandidati zgjedh një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje, pavarësisht nëse i ka zhvilluar ose jo, apo i janë ofruar ose jo ato nga shkolla në programin mësimor.

4. Kandidatit, që ka dhënë dy ose më shumë provime me zgjedhje dhe është vlerësuar me notë të përshkallëzuar jo më të vogël se 4.50 (nota 5), i njihen ato provime dhe nuk mund t'i japë më.



5. Kandidatët, të cilët rezultojnë mbetës në të paktën njërin prej provimeve të Maturës Shtetërore, duhet ta rijapin atë që të pajisen me diplomë.

6. Kandidatët, që në Maturat Shtetërore 2012–2020 nuk kanë rezultuar kalues në asnjë prej provimeve që kanë zgjedhur për të dhënë, japin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij udhëzimi.

7. Datat për provimet e Maturës Shtetërore 2021 të jenë:

- a) Gjuhë e huaj: 3 qershor 2021;
- b) Gjuhë shqipe dhe letërsi: 7 qershor 2021;
- c) Matematikë: 11 qershor 2021;
- d) Provimi me zgjedhje: 15 qershor 2021.

8. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2021 bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

9. Provimet e Maturës Shtetërore 2021 fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.

10. Testet e provimeve të Maturës Shtetërore 2021 hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

11. Testi për secilin nga provimet e Maturës Shtetërore 2021 vlerësohet me 60 pikë maksimale.

12. Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2021, i rijapin provimet në sesionin e dytë.

13. Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitare (ZVAP), pasi marrin nga institucionet e arsimit të mesëm të lartë listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2020–2021, i pasqyrojnë ato në portalin e Maturës Shtetërore *online*, sipas udhëzimit dhe kalendarit të përcaktuar nga QSHA-ja. Këto lista i dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik.

14. Institucionet e arsimit të mesëm të lartë të organizojnë konsultimet në ndihmë të nxënësve maturantë për provimet e Maturës Shtetërore, sipas një kalendarit të miratuar nga ZVAP-ja. Këto konsultime do të jenë objekt monitorimi nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar.

15. Testi i provimit “Gjuhë dhe letërsi italiane” (*Lingua e Letteratura italiana*) përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe dorëzohet në QSHA në afatin kohor të përcaktuar për këtë provim. Ky provim zhvillohet në datën 3 qershor 2021. Në notën e provimit përfshihet, siç është parashikuar në

memorandum, edhe vlerësimi i zhvilluar në datën 1 qershor 2021, para një komisioni të ngritur nga palët. Ky provim do të zëvendësojë provimin e gjuhës së huaj (D3) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane.

16. Testi i provimit “Gjuhë frënge” (*DELFB2 scolaire*) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze dhe provimi zhvillohet në datën 25 maj 2021, në shkollat përkatëse.

17. Tërheqja e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2021 bëhet sipas grafikut të hartuar nga QSHA-ja dhe të miratuar nga Komiteti i Maturës Shtetërore 2021.

18. Provimet e Maturës Shtetërore 2021 zhvillohen në qendrat e provimeve të përcaktuara nga Komisioni i Maturës Shtetërore në ZVAP, mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore.

19. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i MASR-së, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

**UDHËZIM****Nr. 65, datë 4.2.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM
PËR FITIMIN, HEQJEN DORË DHE
RIFITIMIN E SHTETËSISË
SHQIPTARE, FORMËN DHE
MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË
KËRKESËS, TË PROCEDURËS PËR
KRYERJEN E VERIFIKIMEVE PRANË
INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE, SI
DHE TË PROCEDURËS DHE TË
DOKUMENTACIONIT PËR SHTYRJEN
E AFATIT PËR KRYERJEN E BETIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 6; të pikës 7, të nenit 8; të pikës 3, të nenit 10; të pikës 2, të nenit 11; të pikës 2, të nenit 13; të pikës 1, të nenit 17; të pikës 3, të nenit 18; të pikës 1, të nenit 19; dhe të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”,

UDHËZOJ:**I. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR
FITIMIN E SHTETËSISË ME ORIGJINË**

1. Shtetësia shqiptare fitohet nga i huaji, të paralindurit e të cilit kanë origjinë shqiptare, me kusht që të provohet lidhja familjare në vijë të drejtë, deri në tri shkallë, e kërkuarit me të paralindurit.

a) kërkesë e shtetasit drejtuar Presidentit të Republikës;

b) certifikatë personale dhe familjare;

c) certifikatë apo çdo dokument tjetër mbi bazën e të cilit vërtetohet origjina shqiptare e kërkuarit, në vijë të drejtë, deri në tri shkallë, qoftë dhe nga njëri prind;

d) dëshmi penaliteti, të lëshuar nga shteti ku është rezident;

e) vërtetim i gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

**II. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR
FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE ME
NATYRALIZIM**

1. I huaj mbi 18 vjeç, me qëndrim të rregullt në Shqipëri:

a) kërkesë e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës;

b) dokumentet për nivelin A2 të njohurive të gjuhës shqipe (lëshuar nga institucioni përkatës arsimor) dhe të ketë kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë;

c) leje e përhershme qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

d) vërtetim nga Autoriteti i Kufirit dhe Migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) akti i pronësisë së banesës ose kontrata e marrjes me qira të banesës (fotokopje e noterizuar);

f) dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noterizuar);

g) kontratë pune për të punësuarit ose vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (fotokopje e noterizuar);

h) dëshmi e gjendjes gjyqësore e marrë në vendin e origjinës, në një shtet të tretë dhe në vendin ku kërkuari ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit;

i) mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë (përpilohet nga seksioni i policisë kriminale);

j) fotografi e aplikantit, tri copë (në rast se ka fëmijë nën moshën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre);

k) mandatpagesë.

2. Person pa shtetësi:

a) kërkesë e personit pa shtetësi drejtuar Presidentit të Republikës;

b) leje e përhershme qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

c) vërtetim nga Autoriteti i Kufirit dhe Migracionit, që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;



d) dëshmi e gjendjes gjyqësore e marrë në vendin e origjinës, në një shtet të tretë dhe në vendin ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit;

e) mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë (përpilohet nga seksioni i policisë kriminale);

f) fotografi e aplikantit, tri copë (në rast se ka fëmijë nën moshën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre);

g) mandatpagesë.

3. I huaji i martuar me shtetas shqiptar:

a) kërkesë e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës;

b) certifikata e lindjes dhe familjare;

c) certifikatë martese.

d) lejeqëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

e) akti i pronësisë së banesës ose kontrata e marrjes me qira të banesës (fotokopje e noterizuar);

f) dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noterizuar);

g) dëshmi e gjendjes gjyqësore e marrë në vendin e origjinës, në një shtet të tretë dhe në vendin ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit;

h) mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore për sjelljen dhe për qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë (përpilohet nga seksioni i policisë kriminale);

i) fotografi e aplikantit, tri copë (në rast se ka fëmijë nën moshën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre);

j) mandatpagesë.

4. I huaji, fëmija i mitur i të cilit ka shtetësi shqiptare:

a) kërkesë e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës;

b) dokumentet për nivelin A2 të njohurive të gjuhës shqipe (lëshuar nga institucioni përkatës arsimor) dhe të ketë kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë;

c) certifikata e lindjes dhe familjare;

d) certifikata e lindjes së fëmijës me shtetësi shqiptare;

e) leje qëndrimi të vlefshme e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

f) vërtetim nga Autoriteti i Kufirit dhe Migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 3 (tre) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

g) akti i pronësisë së banesës ose kontrata e marrjes me qira të banesës (fotokopje e noterizuar);

h) dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noterizuar);

i) dëshmi e gjendjes gjyqësore e marrë në vendin e origjinës, në një shtet të tretë dhe në vendin ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit;

j) mendimi me shkrim i formuluar nga komisarati i policisë vendore ku aplikuesi ka banimin. Ky dokument duhet të përmbajë gjeneralitetet e aplikuesit, adresën e saktë të vendbanimit. Mendimi duhet të sqarojë sjelljen e aplikuesit gjatë kohës së tij në Shqipëri, precedentin e tij penal (nëse ka);

k) fotografi e aplikantit, tri copë (në rast se ka fëmijë nën moshën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre);

l) mandatpagesë.

5. Fëmija i dy prindërve që kanë fituar shtetësinë me natyralizim:

a) kërkesë nga të dy prindërit ku shprehet dhe pëlqimi i fëmijës kur është në moshën 14–18 (katëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë) vjeç, drejtuar Presidentit të Republikës;

b) dokumentet për nivelin A2 të njohurive të gjuhës shqipe (lëshuar nga institucioni përkatës arsimor) dhe të ketë kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 (katëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë) vjeç;

c) certifikata e lindjes dhe familjare ku te evidentohet shtetësia shqiptare e fituar nga dy prindërit;

d) lejeqëndrimi të vlefshme, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë,



sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

e) dëshmi e gjendjes gjyqësore e marrë në vendin e origjinës, në një shtet të tretë dhe në vendin ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

f) fotografi e aplikantit, tri copë;

g) mandatpagesë.

6. Fëmija i një prindi që ka fituar shtetësinë me natyralizim:

a) kërkesë nga të dy prindërit ose nga njëri prej prindërve (në këtë rast, prindi tjetër duhet të japë pëlqimin me shkrim) dhe pëlqimi i fëmijës, kur është në moshën 14–18 (katërmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë) vjeç, drejtuar Presidentit të Republikës;

b) dokumentet për nivelin A2 të njohurive të gjuhës shqipe (lëshuar nga institucioni përkatës arsimor) dhe të ketë kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 (katërmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë) vjeç;

c) certifikata e lindjes dhe familjare ku të evidentohet shtetësia shqiptare e fituar nga njëri prind;

d) lejeqëndrimi të vlefshme, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

e) dëshmi e gjendjes gjyqësore e marrë në vendin e origjinës, në një shtet të tretë dhe në vendin ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

f) fotografi e aplikantit, tri copë (në rast se ka fëmijë nën moshën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre);

g) mandatpagesë.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË ME BIRËSIM:

a) kërkesë e bashkëshortëve drejtuar Presidentit të Republikës;

b) akti i lindjes së fëmijës/certifikatë nga akti i lindjes;

c) dokumenti, akti administrativ, mbi bazën e të cilit është vendosur për birësimin e fëmijës;

d) deklaratë noteriale e prindërve.

IV. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR FITIMIN E SHTETËSISË NGA REFUGJATËT, APO PERSONA NË MBROJTJE PLOTË-SUESE:

a) kërkesë e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës;

b) dokument për nivelin A2 të njohurive të gjuhës shqipe (lëshuar nga institucioni përkatës arsimor) të ketë kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë;

c) leje e përhershme qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

d) vërtetim nga Autoriteti i Kufirit dhe Migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) akti i pronësisë së banesës ose kontrata e marrjes me qira të banesës (fotokopje e noterizuar);

f) kontratë pune për të punësuarit ose vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (fotokopje e noterizuar);

g) dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noterizuar);

h) vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar në Republikën e Shqipërisë;

i) vendimi për fitimin e statusit (fotokopje e noterizuar);

j) mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore ku aplikuesi ka banimin, për sjelljen e qëndrimin e tij/saj në Republikën e Shqipërisë (përpilohet nga sektori i policisë kriminale);

k) mandatpagesë.

V. DOKUMENTE QË KËRKOHEN PËR HEQJEN DORË NGA SHTETËSIA SHQIPTARE

1. Për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, shtetasi shqiptar depoziton:

a) kërkesë e shtetasit shqiptar drejtuar Presidentit të Republikës;

b) premtimi nga autoriteti kompetent i vendit të shtetësisë tjetër ose dokument origjinal, ku konfirmohet shtetësia e vendit tjetër;

c) certifikatë lindjeje e aplikuesit*;

d) certifikatë familjare e aplikuesit*;



- e) vërtetim i gjendjes gjyqësore*;
- f) vërtetim i lëshuar nga Gjykata e rrethit*;
- g) vërtetim i lëshuar nga prokuroria e rrethit*;
- h) vërtetimi i lëshuar nga zyra e përmbarimit*;
- i) dokumenti që vërteton rezidencën, vendbanimin e tij në shtetin nga i cili është premtuar shtetësia tjetër;

j) mendimi me shkrim i formuluar nga komisarati i policisë vendore ku aplikuesi ka banimin. Ky dokument duhet të përmbajë gjeneralitetet e aplikuesit, adresën e saktë të vendbanimit. Mendimi duhet të sqarojë sjelljen e aplikuesit gjatë kohës së tij në Shqipëri, precedentin e tij penal (nëse ka).

2. Për fëmijët e moshës 0–14 vjeç të paraqitet:

- a) kërkesë e prindërve apo e kujdestarit ligjor drejtuar Presidentit të Republikës;
- b) certifikatë lindjeje e fëmijës;
- c) deklarata noteriale e të dy prindërve (ose vetëm e njërit prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre (kur aplikohet për fëmijët e tyre deri në moshën 18 vjeç, të cilët duhet të kenë premtim shtetësie nga një vend tjetër).

3. Për fëmijët e moshës 14–18 vjeç, dokumentacioni duhet të paraqitet i plotë, sipas përcaktimeve të pikës 1, për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, si dhe deklarata noteriale e të dy prindërve (ose vetëm e njërit prej prindërve apo kujdestarit ligjor sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre.

Koment. Dokumentet, të cilat kanë shenjë “”, merren në Republikën e Shqipërisë.*

VI. DOKUMENTE QË KËRKOHEN PËR RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Ish-shtetasi shqiptar, që nuk ka fituar shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:

- a) kërkesë e qytetarit drejtuar Presidentit të Republikës;
- b) certifikatë personale dhe familjare;
- c) deklaratë noteriale nga çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç, për faktin e aplikimit ose jo për të fituar shtetësi tjetër, si dhe aktualisht është person pa shtetësi;
- d) vërtetimin e njësisë administrative përkatëse për çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç;

e) certifikatë lindje ose vdekje të prindërve të çdo aplikanti;

f) relacion shpjegues dhe konfirmimi nga komisarati i policisë vendore dhe prefektura përkatëse, lidhur me shtetësinë që kanë ose kanë pasur prindërit e çdo aplikanti (ky relacion përpilohet nga komisarati i policisë vendore, seksioni i policisë kriminale dhe Prefektura e qarkut);

g) fotografi e aplikantit, 3 (tri) copë (në rast se ka fëmijë nën moshën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre).

2. Ish-shtetasi shqiptar që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe ka fituar një shtetësi tjetër, depoziton:

- a) kërkesë e qytetarit drejtuar Presidentit të Republikës;
- b) certifikatë lindjeje dhe familjare;
- c) dëshmi penaliteti të lëshuar në vendin e shtetësisë tjetër që ka aplikanti;
- d) vërtetim i gjendjes gjyqësore të lëshuar në Republikën e Shqipërisë;

e) dokument i cili vërteton heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.

VII. FORMA DHE MËNYRA E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS

1. Kërkesa për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare paraqitet pranë strukturave vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit, të vendbanimit të personit.

2. Aplikimi për fitimin e shtetësisë shqiptare nga shtetas të huaj, bëhet nga vetë kërkuksi (për rastet e fitimit të shtetësisë shqiptare nuk aplikohet nga përfaqësuesi i tij me prokurë të posaçme). Aplikimi për shtetësinë shqiptare është individual, përveç të miturve nën moshën 14 vjeç, për të cilët shprehen prindërit apo kujdestari ligjor i tyre.

3. Kërkesa i drejtohet Presidentit të Republikës dhe duhet të përmbajë: emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, adresën e përhershme, atë të përkohshme, adresën ku pret informim për ecurinë e aplikimit të tij. Në përmbajtje të kësaj kërkesë duhet të parashtrohen qartazi arsyet e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare, periudha e ardhjes në Shqipëri, profesioni i ushtruar në shtetin e huaj dhe në Shqipëri. Aplikanti duhet të sqarojë në mënyrë të hollësishme, duke përshkruar gjithë veprimtarinë



e jetës së tij. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër, firmë dhe datë nga aplikuesi.

4. Dokumentet për shtetësinë shqiptare pranohen kur janë në harmoni të plotë me njëri-tjetrin, pa gabime e pa korrigjime në përmbajtjen e tyre. Dokumentet pranohen në formën e tyre origjinale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përveç rasteve kur për dokumentet e ardhura nga jashtë është i pamundur lëshimi i dokumentit origjinal, për shkak të legjislacionit, atëherë pranohen dokumentet e njësuara me akt noterial.

5. Dokumentet e lëshuara nga administrata e shtetit të huaj duhet të jenë të legalizuara secili më vete, në vendin ku ato janë lëshuar, përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Data e lëshimit të tyre të mos kapërcejë gjashtë muajt e fundit. Afatet e vlefshmërisë llogariten mbi bazën e datës së pranimit të dokumenteve nga drejtoria e vendore e policisë (ose komisarati i policisë vendore).

VIII. PROCEDURA PËR KRYERJEN E VERIFIKIMEVE PRANË INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE

1. Pranimi i aplikimit për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare bëhet nga strukturat e Policisë së Shtetit.

2. Në zbatim të këtij udhëzimi, procedurat e pranimit të kërkesave nga strukturat e Policisë së Shtetit, si dhe dhëniet e mendimit nga specialistët e policisë kriminale, përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

3. Për aplikimet për heqje dorë nga shtetësia shqiptare, Ministria e Brendshme/Spektori i Shtetësisë, vijon me verifikimin e tyre, vetëm në rastet kur aplikimet përcillen nga misionet diplomatike apo postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Në këto raste, punonjësi përgjegjës, kur evidenton se dokumentacioni është i plotë dhe konform ligjit, harton shkresën për çdo aplikues dhe e përcjell atë pranë drejtorisë vendore të policisë, Spektori i Rendit dhe i Sigurisë Publike.

4. Për heqjen e shtetësisë pa kërkesë, në rastet e përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, pas marrjes së informacionit, Ministria e Brendshme, Spektori i Shtetësisë, përgatit shkresën së bashku me materialet përkatëse dhe përcjell për verifikime informacionet e marra në organet ligjzbatuese.

IX. PROCEDURA PËR KRYERJEN E BETIMIT

1. Personi që fiton shtetësinë shqiptare, pas botimit të dekretit të Presidentit në Fletoren Zyrtare, brenda gjashtë muajve, kryen betimin për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe për respektimin e Kushtetutës e të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, para kryetarit të bashkisë, në territorin e së cilës ka vendbanimin ose para punonjësit të autorizuar prej tij.

2. Betimi për fitimin e shtetësisë shqiptare kryhet nga të gjithë personat, të cilëve u është miratuar fitimi i shtetësisë shqiptare, me përjashtim të atyre personave, të cilët janë në kushte të pamundësisë për t’u paraqitur në zyrën e gjendjes civile në bashki /njësi për arsye të justifikuara shëndetësore.

3. Me marrjen e njoftimit për fitimin e shtetësisë shqiptare nga Institucioni i Presidentit të Republikës, personat që u është miratuar shtetësia shqiptare paraqesin në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi administrative dokumentacionin e nevojshëm, të lëshuar nga vendi i origjinës, siç janë dokumentet certifikatë personale, certifikatë familjare dhe certifikatë martese, të përkthyer në gjuhën shqipe, me vulën APOSTILLE ose të legalizuara.

4. Pas dërgimit të dekretit për fitim të shtetësisë shqiptare, zyrës respektive të gjendjes civile në bashki/njësi administrative, paracaktohet në shpallje të lirë publike, data dhe ora e betimit, e cila i korrespondon çdo dite të hënë.

5. Njoftimi për datën e kryerjes së betimit dërgohet në adresën e personit, të cilit i është dekretuar fitimi i shtetësisë shqiptare.

6. Në rastet e fitimit të shtetësisë, sipas nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, betimi mund të kryhet edhe pranë misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë të akredituar në shtetin ku personi ka vendbanimin e fundit.

7. Në përfundim të procedurës së betimit, zyra e gjendjes civile në bashki/njësi administrative kryen procedurat e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010 dhe më pas personi që ka kryer betimin, efektivisht shtetas shqiptar, aplikon për pajisje me dokumentin e identifikimit, letërnjoftim dhe pasaportë.



X. PROCEDURA DHE DOKUMENTACIONI PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR KRYERJEN E BETIMIT

1. Në rast të moszbatimit të afatit 6-mujor (gjashtëmujor) për kryerjen e betimit në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, për shkaqe të justifikuara objektive dhe të arsyeshme, personi, i cili e ka të pamundur të paraqitet për të kryer betimin, duhet të paraqesë kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues në Ministrinë e Brendshme për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit, për aq kohë sa parashikohet se mund të zgjasin shkaqet që kanë diktuar shtyrjen e afatit.

2. Në çdo rast, ky afat duhet t'i korrespondojë një periudhe jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 22, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë". Në këtë rast personi paraqet kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues pranë Ministrisë së Brendshme për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit, për aq kohë sa zgjasin shkaqet që kanë diktuar shtyrjen e afatit.

3. Me paraqitjen e këtyre dokumenteve, të cilat shqyrtohen nga struktura për shtetësinë në Ministrinë e Brendshme, lëshohet konfirmimi për pranimin/mospranimin e kërkesës, i cili më pas i përcillet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila e adreson për ndjekje të mëtejshme në zyrën respektive të gjendjes civile në bashki/njësi administrative, për vijimin e procedurës së betimit për fitimin e shtetësisë shqiptare.

XI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Brendshme dhe strukturat vendore të Policisë së Shtetit.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

UDHËZIM

Nr. 66, datë 4.2.2021

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË REGJISTRIT PËR REGJISTRIMIN E DEKRETIT PËR FITIMIN, RIFITIMIN DHE LËNIEN E SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 20, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë",

UDHËZOJ:

1. Dekretet për fitimin, rifitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare regjistrohen në një regjistër të veçantë për qëllime statistikore.

2. Regjistri administrohet nga struktura përkatëse që trajton çështjet e shtetësisë.

3. Për qëllim të njohjes dhe të vijimit të procedurave për regjistrim/çregjistrim pranë zyrave të gjendjes civile, në këtë regjistër ka akses edhe zyra përkatëse në Drejtorinë e Gjendjes Civile. Zyra përkatëse ka akses me këtë regjistër, duke pasur statusin e njohjes.

4. Regjistri duhet të përmbajë:

- numër dhe datë dekreti;
- emër, atësi dhe mbiemër të personit;
- për rastet e fitimit, shtetësinë e aplikuesit.

5. Të gjitha dekretet duhet të regjistrohen në regjistër nga struktura përgjegjëse, jo më vonë se 15 ditë pas ardhjes në Ministrinë e Brendshme.

6. Format i regjistrit përcaktohet në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Ngarkohet struktura përkatëse në fushën e shtetësisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi



SHTOJCA 1

REGJISTËR I DEKRETEVE PËR FITIMIN, RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE

Nr. dhe data e dekretit		Emër, atësi, mbiemër	Lloji i aplikimit	Shtetësia e aplikuesit	ZGJC e regjistrimit

REGJISTËR I DEKRETEVE PËR LËNIEN E SHTETËSISË SHQIPTARE

Nr. dhe data e dekretit		Emër, atësi, Mbiemër	Lloji i aplikimit	ZGJC e çregjistrimit

URDHËR

Nr. 53, datë 4.2.2021

URDHËROJ:

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE TË PËRMBAJTJES SË DEKLARATËS SË EKSPERTIT PËR MARRJEN DIJENI PËR PËRGJEGJËSINË PENALE NE RAST EKSPERTIMI TË RREMË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 28, pika 3, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”,

1. Miratimin e formës dhe të përmbajtjes së deklaratës së ekspertit për marrjen dijeni të përgjegjësisë penale, në rast ekspertimi të rremë, sipas aneksit bashkëlidhur këtij urdhri, i cili është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Falimentimit për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)



ANEKS

DEKLARATË

Unë i/e nënshkruari/a _____, ekspert/e në fushën e _____,

(emër, atësi, mbiemër)

i/e caktuar nga gjykata e falimentimit, sipas përcaktimeve të nenit 28, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë marrjen dijeni për ngarkimin me përgjegjësi penale për kryerjen e një ekspertimi të rremë, sipas parashikimeve të nenit 309, të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nëpërmjet kësaj deklarate betohem se do të kryej mirë e me nder detyrat që më janë besuar, me të vetmin qëllim që t’i bëj të ditur të vërtetën gjykatës së falimentimit.

DEKLARUESI Datë _____.____.____

(emër, atësi, firmë, vulë)

**URDHËR****Nr. 65, datë 1.2.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 682, DATË 21.12.2020, “PËR
NDALIMIN E LËVIZJES PËRMES
RRUGËVE AJRORE ME BRITANINË E
MADHE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 3, germat “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit; me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19; si edhe të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, 595,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 682, datë 21.12.2020, “Për ndalimin e lëvizjes përmes rrugëve ajrore me Britaninë e Madhe”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi “deri në datën 1.2.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në një urdhër të dytë”.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

VENDIM**Nr. 101, datë 15.12.2020**

**AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE “PËR FUQIZIMIN E TË
RINJVE DHE TË TË REJAVE”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- znj. Anila Denajkryetare;
- znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- znj. Etleva Hakaanëtare;
- znj. Mirjana Zisianëtare.
- z. Ahmet Mançellari anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 15.12.2020, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, mori në shqyrtim njoftimin e Bashkisë Tiranë lidhur me planin e dhënies së ndihmës shtetërore për fuqizimin e të rinjve dhe të të rejave.

I. Procedura

1. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 42363, datë 2.12.2020, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërpërmendur, në hartuar në draftudhëzuesit operacionalë të projektit “Fuqizimi i të rinjve dhe i të rejave”, i cili do të miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak.

II. Përshkrimi i masës

2. Objektivi: Plani i ndihmës ka si objektiv mbështetjen me grante të të rinjve dhe të të rejave të prekur nga pasojat e shkaktuara nga tërmetet që ndodhen në Shqipëri në datat 21 shtator dhe 26 nëntor 2019, si edhe pandemisë globale të shkaktuar nga COVID-19. Skema synon ngritjen e një sipërmarrjeje të qëndrueshme private, duke gjeneruar vende të lira pune dhe duke mundësuar trajnime për hartimin e planit të biznesit.

3. Baza ligjore dhe vlera e ndihmës: Plani i ndihmës shtetërore është e hartuar nëpërmjet draftudhëzuesit operacional të projektit “Fuqizimi i të rinjve dhe i të rejave”, i cili do të miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë. Ndihma do të jepet në formën e grantit në vlerën 16.000.000 lekë. Çdo përfitues do të mbështetet me grant të drejtpërdrejtë në shumën 800,000 lekë. Intensiteti i ndihmës do të jetë 80% e kostove të pranueshme.

4. Kohëzgjatja: Plani i ndihmës do të zbatohet në vitin 2021.

5. Dhënësi i ndihmës dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia e Tiranës.

6. Përfituesit: Përfitues janë ndërmarrje mikro që do të ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Bashkisë së Tiranës, në sektorët e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit



(TIC), agrobujqësisë etj. dhe ndërmarrje që ofrojnë shërbime në treg, duke synuar mbështetjen me grante deri në 20 ndërmarrje.

7. Shtirja territoriale: Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë së Tiranës.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

8. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore për fuqizimin e të rinjve dhe të të rejave, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra, nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje; ka ndikim potencial në konkurrencë dhe tregti në rajon; që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

9. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore.”.

10. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës së aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

11. Sa më lart, ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha

kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, më konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

12. Plan i njoftuar i ndihmës shtetërore lidhet me aktivizimin e burimeve shtetërore në formën e granteve për mbështetjen e 20 ndërmarrjeve mikro. Plan i ndihmës është selektive, pasi Komisioni i Vlerësimit të Grantit do të përzgjedhë aplikantët përfitues, në bazë të kriterëve të përcaktuara në draftudhëzues; synon mbështetjen e sektorëve të përmendur në pikën 6 të këtij vendimi; ka efekt në konkurrencë dhe në tregti; dhe jep një avantazh ekonomik kundrejt ndërmarrjeve ekzistuese në treg, sepse plani synon të mbështesë krijimin ose zgjerimin e aktiviteteve të zbatueshme të ndërmarrjeve nga të rinjtë, të aftë për të pasur sukses në një treg konkurrues dhe shmangien e falimentimit të ndërmarrjet ekzistuese në treg.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

13. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 11, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”, pasi skema e njoftuar e ndihmës shtetërore përmbush, si më poshtë:

- Mbulon kostot e pranueshme si vijon:

a) kostot e investimit në asete të prekshme dhe të paprekshme;

b) kostot e parashikuara të pagave, në lidhje me punësimin e krijuar drejtpërsëdrejti nga projekti i investimit, të përlogaritura gjatë një periudhë dyvjeçare.

- Investimi do të konsiderohet si kosto e pranueshme, pra në asete të prekshme dhe/ose të paprekshme për ngritjen e një ndërmarrjeje të re apo zgjerimin e një ndërmarrjeje ekzistuese, për të diversifikuar prodhimin e një ndërmarrjeje me produkte të reja shtesë ose një ndryshim rrënjësor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të një ndërmarrjeje ekzistuese.

- Vendet e punës të jenë të krijuara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projekti i investimit.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm dhe në

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.



përputhje me nenin 4, dhe 8/1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8/1, 17, 22 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë zbatimin e planit të ndihmës shtetërore në formën e grantit për ndërmarrjet mikro, të parashikuar në draftudhëzuesin operacional të projektit “Fuqizimi i të rinjve dhe i të rejave”.

2. Bashkia e Tiranës, në zbatimin e planit të ndihmës shtetërore të raportoje në Komisionin e Ndhmës Shtetërore mbi efektin nxitës dhe domosdoshmërinë e ndihmës.

3. Bashkia e Tiranës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e kryera dhe rezultatet e arritura.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e plani të ndihmës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të këtij plani.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Anila Denaj

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë